

AKT THEMELIMI

PER SHOQERINE "DEMETRA SOLUTIONS" SH.P.K. FIER

Sot me datën 22/01/2023, ne të nënshkruarit ortakë Marjola Rukaj , babai Aleksandër , lindur më 24/03/1985 në Fier dhe banuese në Lagjen 11 Janari Rruga "Ramiz Aranitasi" nr 41, hyrja ,1 kati i dytë, ap. nr 3 Fier me numër identifikimi I55324092B, kartë identiteti dhe Nils-Gregor Panik, babai Erich 26/08/1981 në Rostock Gjermani, me banim në Lagjen 11 Janari Rruga amiz Aranitasi nr. 41 hyrja 1 kati i dytë sap nr 3 Fier me numër identifikimi C3J3T9ZGR, pasaportë, konform ligjit 9901 date 14-04-2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", hartojmë këtë këtë akt themelimi: Me vullnetin tonë të lirë themelojmë shoqërinë "DEMETRA SOLUTIONS" SH.P.K., pra shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, Bashkë ortakë Marjola Rukaj dhe Nils Gregor Panik.

Themelues e kësaj shoqërie do të jenë Marjola Rukaj dhe Nils Gregor Panik . Selia dhe qendra e shoqërisë ndodhet në Lagjen "APOLLONIA" rruga "XOX ANDON" I hyrja një kati i parë Zona Kadastrale 8534 pas. 3/257-N24 Fier

Vula e shoqërisë përmban " DEMETRA SOLUTIONS" shpk FIER

Krijohet me mjetet financiare pronë e ortakëve Marjola Rukaj dhe Nils Gregor Panik në Masën

Marjola Rukaj 51%

Nils-Gregor Panik 49%

Dhe kapitali fillestar në shumën prej 100 000 (njëqind mijë) lekë, të ndara në të ndara në 100 pjese me vlerë nominale secila 1000 leke, shumë e cila do të ngurtësohet në bankë mbasi shoqëria të jetë regjistruar në QKB

Kjo shoqëri ka statusin e personit juridik shqiptar dhe i nënshtrohet legjislacionit përkatës shqiptar.

Afati i veprimtarisë së saj do të jetë mbi dhjetë vjet kohë. Ky afat mund të zgjatet dhe mund të shkurtohet në rastet kur shoqëria do të shpërbëhet sipas përcaktimeve që pasqyrohen në statut.

Objekti i veprimtarisë se shoqërisë është :

Marketing Softuer, Zhvillim Softueri, konceptim dhe realizim dezajni për softuer, dizajn dhe zhvillim websitësh, aplikacionesh web dhe për mobile. Marrje përsipër zhvillim softueri për kompani te tjera Outsourcing për gjuhe te ndryshme programimi. Grafik Dizajn për Logo, Website, Identitet korporate, tipografi dixhitale, animacion, sisteme automatizimi dixhital. Zhvillim dhe realizim dizajni për dyqane online, Webshop, E-commerce. Rikonceptim Website dhe Design. Kontroll cilësie për softuer dhe aplikacione. Strategji SEO për website dhe aplikacione.

Fotografi, dhe përpunim, video, përmbajtje audio-vizuale digitale, Konsulence për Strategji Marketingu dhe zhvillim biznesi, Konsulence për marketing dixhital, menaxhim i rrjeteve sociale.

MARJOLA RUKAJ

Nils Gregor Panik



Konceptim, realizim dhe monitorim reklama audio-vizuale, dixhitale dhe print.
Tregtim produktesh dixhitale si template, modele grafike dezajni, aplikacione, softueri dhe plug-in-e për website, dhe aplikacione. Tregtim online, E-commerce, Webshop produktesh të ndryshme dixhitale, dhe fizike dhe shërbime .

Ndërmjetësim pasurish të paluajtshme, vlerësim pasurish të paluajtshme, shit-blerje pasurish të paluajtshme, konsulencë investimi në sektorin e pasurive të paluajtshme. Konsulencë e përgjithshme në tregun imobiliar. Ndërmjetësim për shit-blerje, dhe qiramarrje objektesh të paluajtshme për përdorim privat dhe komercial.

Konsulencë Menaxhim Hotelesh. Konsulencë Marketing Hotelesh. Menaxhim hotelesh të llojeve të ndryshme. Shitje Blerje paketash turistike. Konsulencë marketing për biznese në sektorin e turizmit.

Krijim dhe zhvillim startapesh. Dizajn dhe zhvillim platformash prenotimi, dhe shitjeje online paketash dhe produktesh turistike.

Organi më i lartë drejtues i kësaj shoqërie tregtare do të jete një prej ortakëve Zinj. Marjola Rukaj dhe administrator i shoqërisë I cili caktohet për 5 (pese) vjet me të drejte përsëritje. Shoqëria administrohet nga administratori që mund të jete ortaku i vetëm ose një person tjetër. Kompetencat e administratorit caktohen në statut. Me themelimin e këtij akti administrator i shoqërisë caktohet një prej ortakëve Marjola Rukaj .

Në këtë shoqëri mund të aderojnë ortake të tjerë të rinj në kushtet që do të përcaktohen në akt marrëveshjen e bërë në rastin e pranimi të tyre. Po ashtu ortakët kanë të drejtën të ndryshojnë ose shtojnë objektin e veprimtarisë së shoqërisë sipas interesave të veta ekonomike dhe financiare.

Shoqëria ka të drejtë të punësojë specialistë të fushës që i përket objektit të veprimtarisë si dhe punonjës të tjerë me kontratë punë sipas përcaktimeve në Kodin e Punës dhe përgjithësisht me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Do të konsiderohen veprimtari të shoqërisë vetëm ato veprime juridiko-civile që do të kryhen nga organet e saj konform deponimeve në statutin dhe në mbështetje të legjislacionit në fuqi.

Si rregull veprimet ekonomike të shoqërisë mbyllen më 31 dhjetor të çdo viti, përjashtim nga ky rregull do të bëhet kur kërkon organi kompetent ligjor.

Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakëve, administratorit dhe personave të tjerë të punësuar në shoqëri në rast se nuk zgjidhen me pajtim do të zgjidhen nga gjykata kompetente.

Fitimi i nxjerrë nga aktiviteti i ligjshëm i kësaj shoqërie tregtare është në favor të ortakëve të shoqërisë si mbas ndarjes së përqindjes në ortakëri

Ndërkohë ortakët mbartin mbi vehte rrezikun e humbjes deri në masën 100% (njëqind përqind) të kapitalit themeltar dhe atij rezervë.

Për detyrimet që shoqëria mund t'ju ketë personave të tjerë juridike apo fizikë përgjigjet me mjetet e veta financiare dhe materiale.

Për funksionimin normal të shoqërisë do të hartohet statuti i shoqërisë ku do të parashikohen hollësitë e mirëfunksionimit dhe administrimit të saj.

Veprimtaria e saj private ushtrohet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Kjo shoqëri mund të mbyll aktivitetin e vet në rastet e parashikuara në legjislacionin shqiptar dhe në statutin e saj.


Shoqëria do të marrë personalitet juridik me regjistrimin e saj në regjistrin tregtar pranë Qendrës së Regjistrimit të Bizneseve.

Një kopje e aktit të themelimit së bashku me statutin e shoqërisë, depozitohen në QKB

Ortakët e shoqërisë

Marjola Rukaj

Nils Gregor Panik

MARJOLA RUKAJ


NILS-GREGOR
PANIK

